



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:175090
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05719721

Ac.nr.3718/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevc, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses R.R. nga fshati Ll., Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Sh.R., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Rr.R., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S., jurist tek e paditura, me bazë juridike kompensim dëmi material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve në procedurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.222/19 të datës 08.02.2021, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 16.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohen si të themelta ankesa e të autorizuarit të paditëses R.R. nga fshati Ll., Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Sh.R. dhe ankesa e të autorizuarit të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.222/19 i datës 08.02.2021, dhe çështja kthehet në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykatës e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.222/19 të datës 08.02.2021, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Rr.R. nga fsh. Ll., K. Lipjan dhe ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që paditëses R.R. në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material t'ia paguaj shumat si vijon: për dhimbje fizike shumë prej 5,000.00 euro, për frikën e pësuar shumë prej 4,500.00 euro, për shkak të zvogëlimit të përhershëm të aktivitetit shumë prej 5,000.00 euro, në emër të shëmtimit trupor shumë prej 4,500.00 euro, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të invaliditetit posaçërisht të rëndë për të atin, nënë dhe motrën në shumë prej nga 2,000.00 euro, gjithsejtë

shumën prej 6,000.00 euro. Në emër të dëmit material t'ia paguaj shumat si vijon: në emër të ndihmës dhe përkujdesit nga personi tjetër shumën prej 810.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 630.0 euro, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 147.50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri te pagesa definitive. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 1,466.80 euro, t'ia paguaj paditësit në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit. Në pikën tre, ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses R.R. mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i paditëses brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin në pjesën refuzuese ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta prish aktgjykimin e shkallës së parë duke gjykuar shuma më të ulëta apo çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe vlerësimit të thënieve ankimore, gjeti se:

-Ankesat janë të themelta

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit ligjor dhe të autorizuar, kundër të paditurës, ka parashtruar padi, të precizuar sipas parashtresës së datës 14.01.2021, për kompensimin e dëmit jo material dhe shpenzimet e trajtimit mjekësor, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 83,708.00 euro. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, për nga baza dhe lartësia.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqës si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, për konstatimin e shkallës së lëndimeve të pësuar trupore, shëmtimit si dhe frikës së përjetuar të paditëses ka caktuar ekspertët mjeko ligjor dr. A.F.-ortoped traumatolog, dr. Y.Z.-kirurg plastik dhe dr.M.A.-psikiatër, ku është konstatuar se si rezultat i aksidentit paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore, më detajisht të përshkruara si në

ekspertizë dhe arsyetim të aktgjykimit të atakuar, nga çka duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 të Ligjit të Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, nenit 159, 169 dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382, par.2 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2, pika n), lidhur me nenin 160, 257 dhe 258, të LPK-së, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vendosur si aktgjykimin e atakuar ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e tij për faktin se gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses lidhur me dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore të invaliditetit posaçërisht të rëndë për të atin, nënën dhe motrën në shumë prej nga 2,000.00 euro, gjithsejtë shumë prej 6,000.00 euro, duke mos arsyetuar këto shuma si dhe mënyrën e vendosjes. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që e njëjta nuk ka vendosur lidhur me precizimin e kërkesëpadiës të bërë nga pala paditëse me parashtresën e datës 14.01.2021, në të cilën është kërkuar kompensimi i dëmit jo material edhe për atin, nënën dhe motrën e paditëses, duke mos legjitimuar kështu si palë në procedurë me emra përkatës edhe familjarët e paditëses, ndërsa nuk ka vlerësuar edhe faktin nëse i autorizuari i paditëses ka autorizim që të përfaqësoj edhe familjarët e paditëses lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit.

Shkelja tjetër konsiston në atë se gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar nuk ka vendosur lidhur me kamatën ligjore të kërkuar nga pala paditëse, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye lidhur me caktimin e kamatës në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes së vendimit të shkallës së parë si dhe bazën ligjore të saj. Tutje, gjykata duke vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, duke mos specifikuar në mënyrë të saktë shumat e refuzuara të kërkesëpadiës së paditëses për secilën kategori të dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që në rastin konkret nuk ka nxjerr ekspertizë të komunikacionit, duke mos vërtetuar kështu drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, sa i përket kontributit të paditëses në shkaktimin e aksidentit. Andaj, nga të lartcekurat gjykata ankimore vlerësoj se duhet pranuar ankesat e palëve si të themelta dhe të prishet aktgjykimi i atakuar ndërsa çështja kthehet në rigjykim.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta bëjë eliminimin e shkeljeve në pajtim me vërejtjet e paraqitura duke zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e nenit 257 dhe 258 të LPK-së, lidhur me precizimin e padisë sa i përket atit, nënës dhe motrës e paditëses, të nxjerr ekspertizë të komunikacionit në mënyrë që të mund të vlerësoj kontributin e paditëses në shkaktimin e aksidentit duke vërtetuar kështu në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, duke vendosur edhe për shpenzimet e procedurës varësisht nga sukcesi i palës në procedurë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195, paragrafi 1, pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3718/2021, më datë 16.05.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.